

Kujdes nga mashtrimet me anë të kodit të përgjigjes së shpejtë QR (Quick Response)

Për shkak të pandemisë COVID-19, menutë e restoranteve u zëvendësuan nga kodet QR që ngjiteshin në sipërfaqe të tavolinës. Meqënëse në ditët e sotme, të gjithë kanë një smartphone, kodet QR janë alternativa me e përshtatshme për të aksesuar URL-në e faqes web të restorantit duke përdorur telefonat e tyre.

Më parë, kodet QR përdoreshin kryesisht për qëllime reklamimi, si një mënyrë e shpejtë për të vizituar një faqe interneti ndërsa je duke lexuar një revistë në formatin letër. Kodi QR nuk u krijua për përdorimet e mësipërme. Arsyeja e vërtetë e krijimit të tij në vitin 1994, ishte për të ndjekur dhe kontrolluar cilësinë e makinave gjatë ndërtimit të tyre në linjën e prodhimit. Por shpejt u bënë të njohura për lidhjen e tyre me faqet e internetit. Kodeve QR u mungojnë masat e sigurisë pasi përdorimi i tyre i tanishëm nuk ishte qëllimi fillestar i krijimit të tyre.

Kodet e Përgjigjes së Shpejtë (QR) krijohen në mënyrë të rastësishme dhe gjenerohen miliona imazhe unike. Gjithsesi, teknologjia nuk mund të identifikojë një URL që nuk tregon në të vërtetë faqen web për të cilën është krijuar kodi QR. Kjo bën që kodet QR të jenë një mjet mjaft i mirë për sulmet phishing.

Nuk duhet të skanohet cdo kod QR

Kodet QR gjenden kudo, ndaj personat nuk mendojmë dy herë përpara se t'i përdorin. Në San Antonio, Teksas dhe Atlanta u bënë mashtrime me kod QR duke përdorur faqen e parkimit të makinave. Mashtruesit thjesht ngjiten kodin QR të rreme në parkingjet e qytetit. Viktimat u dërguan në një faqe interneti duke kërkuar informacione të kartës së tyre të kreditit, i cili më pas u vodh dhe u përdor për të kryer transaksione.

Kodet QR në vendet publike përdoren lehtësisht për mashtrime nga hakerët, njësoj si sulmi phishing me email. Sigurohuni që pas skanimit të kodit, URL-ja e faqes që del në shfletues, është ajo ku dëshironi të shkoni. Gjithashtu, vëzhgoni me kujdes dizajnin e faqes për të kapur ndonjë gabim për të kontrolluar nëse është faqja e internetit e kërkuar.

Asnjëherë mos skanoni një kod QR të dërguar me email

Për arsye sigurie nuk duhet të skanoni një kod QR të dërguar me email. Arsyeja e vetme që një kod QR dërgohet me email është fshehja e një linku mashtrues për të anashkaluar masat e sigurisë të vendosura nga një organizatë.

Mashtguesit që përdorin këtë metodë zakonisht përpiqen të mashtrojnë një korporatë të madhe si psh, një bankë, pasi ato përdorin mjete të reja teknologjike si kodet QR.

Kujdes kur bëni pagesa me anë të kodit QR

Pagesat me anë të kodit QR, është një alternative që shumë kompani dëshirojnë ta adoptojnë, por kanë dështuar. Arsyeja kryesore është për shkak të përdorimit të ulët të kodeve QR nga konsumatorët dhe çështjet e sigurisë, pasi kodet QR përdoren lehtësisht për mashtime.

Megjithatë, pagesa me anë të kodit QR përdoret shumë në Kinë dhe disa pjesë të Azisë. Korporatat e mëdha dhe madje shitësit ambulantë i përdorin ato për të kryer transaksione të përditshme me klientët. Nëse udhëtoni në vendet perëndimore dhe ju kërkohet të bëni pagesë me anë të kodit QR, është më mirë të kërkonit një mënyrë alternative pagese.

Nëse tregtari këmbëngul që pagesa të bëhet me anë të kodit QR, kjo gjë duhet të konsiderohet si një indikator për të mos e bërë. Nëse është opsioni i vetëm, sigurohuni që aplikacioni që përdoret për të bërë pagesën të jetë i njohur. Për shembull, në Azi, këto pagesa zakonisht kryhen përmes WeChat ose AliPay. Këtyre platformave mund t'u besohet pasi ato kontrollojnë miliarda dollarë transaksione çdo vit.

Çdo platformë tjetër ose aplikacion i dyshimtë nuk duhet të përdoret kurrë për pagesa me anë të kodit QR.

Gjithmonë skanoni kodin QR me kamerën e telefonit tuaj

Dyqanet që bëjnë pagesa me anë të kodit QR përdorin shumë aplikacione për skanimin e kodit. Disa softuerë janë të thjeshtë, të ndërtuar mirë, dhe të njohur, ndërsa shumë prej tyre janë mashtime. Ata janë malware që injektojnë kodin e tyre dashakeq kur skanohet kodi QR, për t'ju drejtuar në një faqe interneti mashtuese.

Zgjidhja është e thjeshtë: përdorni aplikacionin e kamerës së smartphone-it tuaj. Pavarësisht nëse sistemi i tij është Android ose iOS, aplikacioni i kamerës i lexon kodet QR dhe tregon një pamje paraprake të URL-së së faqes, përpara se të klikohet mbi të. Mund t'i besoni sigurisë së aplikacionit të krijuar nga Apple ose Google për të penguar përpjekjet e phishing me funksionin e shikimit paraprak të URL-së së faqes së internetit.

Tregoni kujdes ndaj përdorimit të kodeve QR të rrjeteve sociale

Ashtu si kodet QR të emailit të përmendur më parë, nuk duhet të klikoni kurrë në një kod QR të dërguar me anë të mesazheve nga një faqe e një rrjeti social. Disa platforma sociale, si Spotify dhe Snapchat, përdorin një version të kodeve QR që përdoruesit të lidhen më lehtë me këto platforma.

Duke u nisur nga këto platforma, hakerët kanë arritur të ndryshojnë në mënyrë dixhitale imazhet e kodit QR të tyre për të mashtruar përdoruesit që të vizitojnë një uebsajt tjetër mashtrues pas skanimit. Prandaj, duhet të skanoni vetëm kodet QR të shfaqura në faqen zyrtare të internetit ose aplikacionit të platformës përkatëse të rrjeteve sociale. Në këtë mënyrë, siguroheni se kodi QR nuk është modifikuar për qëllime të këqija.